



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës
Opština Podujeva / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E PRONËS KADASTRIT DHE GJEODEZISË

Bazuar në nenin 62.3shkronja b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, nenin 17.2 të Ligjit për dhënien në shfrytëzimin dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenin 17 paragrafi 2.3 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe nenin 64.4 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, bëne këtë:

NJOFTIM PUBLIK

Njoftohen përfaqësuesit e Organizatave të Shoqërisë Civile – OJQ-ve lokale që të bëjnë propozimet e anëtarëve të tyre për plotësimin e përbërjes së Komisioneve që do të ngritën në Kuvendin e Komunës së Podujevës dhe atë;

Komisioni ad-hoc vlerësues për zbaimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për njësit kadastrale në vijim:

- Njësia kadastrale P-00495-4 me sipërfaqe 23403 m², Livadh me klasë 4 në vendin e quajtur "Bugurdull" Zona Kadastrale Lupç i poshtëm me destinim sipas Hartës Zonale Kadastrale Zonë Bujqësore
- Njësia kadastrale P-00594-0 e cila gjendet në Zonën Kadastrale Turuqicë me sipërfaqe prej 25397 m² në vendin e quajtur "Fshati" me shfrytëzim aktual Mal me Klasë 6 me destinim sipas Hartës Zonale Kadastrale Miniera dhe Gurore
- Njësia kadastrale P-00596-0 e cila gjendet në Zonën Kadastrale Turuqicë me sipërfaqe prej 16214 m² në vendin e quajtur "Fshati" me shfrytëzim aktual Tokë jo pjellore me destinim sipas Hartës Zonale Kadastrale Miniera dhe Gurore
- Njësia kadastrale P-00597-0 e cila gjendet në Zonën Kadastrale Turuqicë me sipërfaqe prej 768 m² në vendin e quajtur "Fshati" me shfrytëzim aktual Livadh i Klasës 4 me destinim sipas Hartës Zonale Kadastrale Miniera dhe Gurore
- Objekti afarist i cili është i ndërtuar në njësin kadastrale P-01341-2 në vendin e quajtur "Kriqë" Tokë jo pjellore me sipërfaqe prej 940 m² Oborr dhe 1650 m² objekt afarist në Zonën Kadastrale në Orllan

- **Lokalet afariste** të cilat janë të ndërtuara në njësin kadastrale **P-00244-1** në **Zonën Kadastrale Podujevë** konkretisht në Tregun e Qytetit me Destinim sipas Hartës Zonale Kadastrale Zonë Ndërtimore:
- Lokali afarist **Nr.7** me sipërfaqe 40,72 m²
- Lokali afarist **Nr.8** me sipërfaqe 28,17 m²
- Lokali afarist **Nr.21** me sipërfaqe 28,17 m²
- Lokali afarist **Nr.22** me sipërfaqe 28,17 m²
- Lokali afarist **Nr.36** me sipërfaqe 15,37 m²
- Lokali afarist **Nr.52** me sipërfaqe 15,37 m²
- Lokali afarist **Nr.53** me sipërfaqe 15,37 m²
- Lokali afarist **Nr.54** me sipërfaqe 15,37 m²

Në kuadër të Komisioneve në fjalë do të përfshihet nga një anëtar i sektorit jo qeveritar lokal.

Personat e nominuar për Komisionet e cekura, ndër të tjera, duhet t'i dorëzojnë; CV e tyre si dhe një Letër Interesim – rekomandim për pjesëmarrje në këto Komisione, ku prezantohen arsyet e nominimit.

Përzgjedhja e përfaqësuesve bëhet me votim në Kuvendin e Komunës.

Afati për aplikim është nga data **22.02.2024** deri më **29.02.2024**, brenda orarit zyrtar të punës, dhe të njëjtat bëhen përmes Qendrës për Shërbim me Qytetarë.

Propozimet gjithashtu mund të dërgohen edhe përmes postës elektronike zyrtare, në emailin; dkpgj.podujeva@rks-gov.net

Nr.Pro: 08-020/04-0012573/24
Datë 22.02.2024

